



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 16.1.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 16.1.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 65 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në vijim të vendimit të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 16.12.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ka kërkuar Komisionerit Publik vlerësimin e tij, lidhur me mënyrën e trajtimit të denoncimeve të publikut.

Duke parashtruar nevojën e zbatimit të pikës 5, të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në trajtimin e denoncimit të fakteve nga ana e publikut, në vijim paraqesim qëndrimin e Komisionerit Publik në lidhje me denoncimet e ardhura pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe ato të përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

A.1. Denoncimet pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë

1. Denoncim nga shtetasi *.***, dërguar në adresën zyrtare të postës elektronike në datën ***.8.2018, lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ku ngrihen disa çështje si:**

1.1 Subjekti ka përfituar kredi si i pastrehë në kundërshtim me ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, si dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007. Ndërkohë që merrte kredi si i pastrehë, nuk ka deklaruar shtesën prej 123 m,² të vilës në proces legalizimi. Gjithashtu ka fshehur pronësinë e vilës në ***, Tiranë, në emër të vëllait të tij.

1.2 Subjekti ka ndërtuar hotel luksoz në ***, Tropojë.

1.3 Ka lidhje me trafikantët ndërkombëtarë ***.*** dhe ***.***.

2. Denoncim nga shtetasja ***,***, datë ***.8.2018, me anë të postës elektronike, pranë Komisionerëve Publikë, ku pretendon si në vijim:

2.1 Subjekti zotëron një vilë katër kateshe në *** të Tiranës, të cilën e ka fshehur në emër të vëllait dhe të motrave, duke u hequr vetë si i pastrehë dhe duke përfituar kredi të butë, në kundërshtim me ligjin. Ka fshehur dhe legalizimin e vilës.

2.2 Ka ndërtuar hotel në ***, një nga hotelet më luksoze të zonës, me 20 dhoma, të cilin e ka paraqitur si shtëpi pushimi.

2.3 Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim për huat dhe dhuratat nga motrat. Gjithashtu, dhe vëllai rezulton gjithë kohës i papunë dhe ka disa prona.

3. Denoncim nga shtetasja ***,***, përmes postës elektronike, në datë ***.11.2018, të fakteve në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës.

3.1 Bazuar në këtë denoncim, rezulton se subjekti ka një vilë trekateshe në mes të Tiranës dhe hotel në ***. KPK-ja nuk ka hetuar me çfarë lekësh e bleu vilën në vitin 2004, vëllai i subjektit, marangoz nga Tropoja.

3.2 Në vitin 2006, subjekti ka ndërtuar katin e tretë pa leje, ndërtim të cilin nuk e ka deklaruar në D-Vett., dhe Komisioni nuk e ka konsideruar shkelje.

3.3 Subjekti ka marrë kredi të butë nga Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë jo të rregullt, duke cenuar figurën e prokurorit në këtë rast, pasi kishte banesë dhe kishte ndërtuar pa leje. Kredinë e butë e ka përdorur përsëri për blerjen e gjysmën së vilës së vëllait të tij. Një pjesë të parave për blerjen e vilës i ka marrë borxh nga kunati, ku nga Komisioni nuk është hetuar mënyra e kthimit të kësaj huaje, duke krijuar kuadrin e një rasti tipik të pastrimit të parave.

3.4 Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim për hotelin në ***, por që, faktikisht, e deklaroi si shtëpi, të cilin prapë e deklaroi në pronësinë e të vëllait (marangoz), por që janë para që rrjedhin nga korrupsioni.

A.2. Marrë në konsideratë denoncimet e sipërcituara dhe rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, evidentohen mangësi të tilla që nuk përmbushin realizimin e kontrollit të kriterit të pasurisë. Për këtë arsye, Komisioneri Publik ka kërkuar një hetim të plotë të pasurive si vijon:

A.2.1 Për pasurinë “*Shtëpi në ****”, Komisioneri Publik ka kërkuar hetim në lidhje me:

(i) Evidentimin e situatës faktike të pasurisë së deklaruar “*Shtëpi në ****”, në drejtim të funksionit dhe të numrit të kateve të saj.

(ii) Evidentimin e vlerës së investimit nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë si bashkinvestitorë, për pasurinë e deklaruar “*Shtëpi në ****”, referuar dokumentacionit të depozituar për marrjen e lejes së ndërtimit dhe përlllogaritjen e shpenzimeve për godinën në funksion të objektit si strukturë hoteliere.

(iii) Verifikimin e lejes së ndërtimit për pasurinë e deklaruar “*Shtëpi në ****” dhe mënyrën e zbatimit të saj.

(iv) Cilësimin eventuale si persona të tjerë të lidhur të z. ***,*** dhe znj. ***,***, dhe justifikimin me dokumentacion ligjor të të ardhurave që kanë shërbyer si investim në pasurinë “*Shtëpi në ****”.

A.2.2 Për pasurinë “Ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²” Komisioneri Publik ka kërkuar hetim në lidhje me:

- i)** Plotësimin e kriterëve për përfitimin nga kredia me kushte lehtësuese;
- ii)** Evidentimin e kohës së përfundimit të katit shtesë 113 m², deklaruar në DV-2007, gjendja e saj deri në vitin 2011;
- iii)** Burimin e të ardhurave të ligjshme të krijimit të pasurisë “Ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”;
- iv)** Evidentimin e saktë për numrin e kateve dhe pjesën takuese mbi pasurinë “Ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”;
- v)** Ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit dhe të trajtimit preferencial në çmimin e blerjes me më pak se 1.700.000 lekë, nga vlera faktike e ndërtimit nga z. ***.***, në favor të z. ***.***, në konsideratë të fakteve se subjekti banonte në këtë pasuri para transaksionit të shitjes dhe ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- vi)** Vlerësimin eventualisht të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë “Ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”, nga personi tjetër i lidhur, z. ***.***, në varësi kjo të dokumentacionit të administruar për elementin e mësipërm që parashtrohet për hetim.

4. Lidhur me denoncimin e shtetasit ***.***, protokolluar pranë IKP-së me nr. *** prot. datë ***.11.2018, dhe denoncimin e shtetasit ***.***, me nr. *** prot., datë ***.12.2018, Komisioneri Publik vlerëson se nuk përmbajnë indicie që mund të ndikojnë në kriteret e rivlerësimit për z. Dollapaj, duke qenë se lidhen me zgjidhjen e çështjeve respektive në themel.

A.3. Tri janë denoncimet e përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pas depozitimit të ankimit, si më poshtë:

- (i)** z. ***.***, protokolluar në IKP me nr. *** prot., datë ***.4.2019;
- (ii)** z. ***.***, protokolluar në IKP me nr. *** prot., datë ***.4.2019;
- (iii)** z. ***.***, protokolluar në IKP me nr. *** prot., datë ***.12.2019.

5. Denoncimi i shtetasit ***.***, përmes postës elektronike, ku denoncuesi pretendon si në vijim:

5.1 Subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me trafikantin ***.***, si dhe ***.***.

5.2 Ka vënë pasuri me anë të korrupsionit dhe citon vilën në *** dhe hotel në ***, të cilat i fsheh në emër të familjarëve të tij dhe të vëllait. Gjithashtu ka marrë kredi si i pastrehë në kundërshtim me ligjin.

5.3 Ka liruar njerëz nga burgu për tentativë vrasje, në vitin 2007.

5.4 Lidhur me anën formale, denoncuesi është identifikuar si z. ***.***.

5.5 Faktet e referuara në përmbajtjen e këtij denoncimi janë trajtuar nga Komisioneri Publik në ankimin e paraqitur para Kolegjit.

5.6 Për sa i përket lidhjeve të ngushta me trafikantët ***.*** dhe ***.*** nuk ka indicie të mjaftueshme apo rrethanë që të lidhë subjektin e rivlerësimit me këta persona.

6. Denoncimi i shtetasit ***.***, ku denoncuesi pretendon si në vijim:

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka qenë në hetim për korrupsion dhe ka çështje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

6.2 Denoncuesi identifikohet në pozicionin e oficerit në Drejtorinë e Forcave Operacionale në Policinë e Shtetit dhe se forcat e kësaj drejtorie kanë ndjekur dhe përgjuar subjektin me urdhër të prokurorit.

6.3 Bazuar në të dhënat e denoncimit, çështjen e ka pasur në shqyrtim prokurorja ***.***, në vitin 2018, dhe nga përmbajtja e akteve të dosjes pretendohet se rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Dollapaj, është vëzhguar, filmuar dhe përgjuar për një bashkëpunim me një prokuror të Tiranës, duke u pretenduar po ashtu se është përfituar prej tyre një vlerë e caktuar financiare në mënyrë të paligjshme. Denoncuesi referon se aktualisht dosja ndodhet pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.

6.4 Edhe në këtë rast, formalisht, denoncuesi është identifikuar si ***.***.

6.5 Sjellim në vëmendje të Kolegjit, i cili ushtron juridiksionin kontrollues dhe rivlerësues, se ankimi i Komisionerit Publik në rastin konkret është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit. Denoncimi në fjalë është depozituar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pas depozitimit të ankimit nga ana e Komisionerit Publik. Nisur nga pozita procedurale e posaçme, Komisioneri Publik, në rastin e këtij denoncimi, është në pamundësi për të mbledhur qoftë dhe indicie që vijnë nga dokumentacioni i administruar nga institucionet publike dhe private. Referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, denoncimi konkret, në dukje, përmban të dhëna që mund të verifikohen pranë prokurorisë përkatëse, në rast se janë të vërteta apo të rreme.

7. Denoncimet e shtetasit ***.***, i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit në funksionin e Drejtorit të Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, me anë të dy letrave kthim përgjigje, të datës ***.12.2008 dhe ***.5.2014, e ka dëmtuar seriozisht, duke shkelur rëndë detyrën shtetërore.

7.1 Denoncimi nuk përmban shkaqe të mjaftueshme për vlerësimin e pretendimeve.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

Aneks 1. Lista e denoncimeve (10) të administruara në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

**Lista e denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit
z. Arben Dollapaj**

Nr. prot. i IKP-së	Datë	Denoncuesi	Institucioni që ka administruar denoncimin	Mënyra e dërgimit
***	***.8.2018	z. ***.***	Komisionerët Publikë	Dorazi
***	***.8.2018	z. ***.***	Komisionerët Publikë	Me postë
***	***.8.2018	z. ***.***	Komisionerët Publikë	Me email
***	***.8.2018	znj. ***.***	Komisionerët Publikë	Me email
***	***.11.2018	znj. ***.***	Komisionerët Publikë	Me email
***	***.11.2018	z. ***.***	Komisionerët Publikë	Me email
***	***.12.2018	z. ***.***	Komisionerët Publikë	Me postë
***	***.4.2019	z. ***.***	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	Me postë
***	***.4.2019	z. ***.***	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	Me postë
***	***.12.2019	z. ***.***	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	Me postë